

THE USE OF ALBANIAN LANGUAGE IN NORTH MACEDONIA FROM THE INDEPENDENCE (1991) UNTIL THE OHRID FRAMEWORK AGREEMENT (2001)

Teuta Arifi

Faculty of Philology, UKIM, Skopje, R. North Macedonia, teutarifi@gmail.com

Abstract: This paper aims to analyze the problem of the use of the Albanian language in North Macedonia, during the period between 1991-2001, as the initial period of political pluralism and the period of placing ethnic topics on the real agenda of social life. The theoretical basis of the paper are the theories expressed by: Banac, Ackermann, Petiffer, Brubacker and Lijphard, speaking on the dissolution of socialist federations and the replacement of communist ideology with unresolved ethnic issues. According to these theories, ethnic issues have remained in a state of hibernation within socialist-multinational federations, while the communist ideology has never been able to be that amalgam which would suppress ethnic identities at the expense of a class ideology. This is the main reason that these federations were dissolved along ethnic lines. The common denominator of these dissolutions have been wars and conflicts of different sizes completed with peace agreements regarding the ethnic issues, whether they are of territorial or non-territorial nature. The Albanian language and its use is not an issue that appears as unknown issue in the newly independent Macedonia, on the contrary, the use of Albanian language it is regulated by the Constitutional documents of the socialist federal unit of Macedonia from 1946 until the last amendments of its socialist Constitution of 1989. The declaration of independence of Macedonia in 1991, will face the internal challenge of inter-ethnic relations which have to be dealt on a different platform and out from the ideology of former Federation. In this direction, the aspect of the institutional use of the Albanian language as one of the identity values makes the core of the debate and the main challenge in the process of the first decade of state building of North Macedonia. In this paper, the base of analysis is the Constitution of independent Macedonia of 1991 and the place of the Albanian language within this document and the arguments and counter-arguments regarding the official use of the Albanian language. Interest of this paper are also the recommendations of the OSCE High Commissioner for National Minorities regarding identity issues.

Keywords: inter-ethnic relations, mother tongue, Constitution, identity, linguistic rights;

GJUHA SHQIPE NË MAQEDONINË E VERIUT NGA PAVARËSIA (1991) DERI TEK MARRËVESHJA KORNIZË E OHRIT (2001)

Teuta Arifi

Fakulteti Filologjik, USHKM, Shkup, teutarifi@gmail.com

Abstrakt: Punimi në fjalë ka për qëllim analizën e problematikës së përdorimit të gjuhës shqipe në Maqedoni, respektivisht periudhën e dhjetëvjeçarit 1991-2001, si periudhë fillestare e pluralizmit në kuptimin politik dhe periudhë e vendosjes së temave etnike në agjendën reale të jetës shoqërore. Bazën teorike të punimit e përbëjnë teoritë e shprehura nga: Banac, Akerman, Petifer, Brubaker dhe Lijphard, lidhur me shpërbërjen e federatave socialiste dhe zëvendësimi i ideologjisë komuniste me çështjet e pazgjidhura etnike. Sipas këtyre teorive, çështjet etnike kanë qëndruar në një gjendje hibernacioni përbrenda këtyre federatave shumëkombëshe, ndërkohë që ideologjia komuniste asnjëherë nuk ka mundur të ishte ai amalgam i cili do të suprimonte identitetet etnike në llogari të një ideologjie klasore. Kjo edhe përbën arsyen kryesore që shpërbërjet e këtyre federatave u realizuan përgjatë vijave etnike. Dhe këto shpërbërje për emërues të përbashkët kishin luftërat dhe konfliktet e përmasave të ndryshme, për të përfunduar me marrëveshje paqësore lidhur me këto tema etnike, qofshin ato të natyrës territoriale apo joterritoriale. Gjuha shqipe dhe përdorimi i saj nuk është çështje e cila shfaqet si e panjohur në Maqedoninë e sapopavarësuar, përkundrazi si një prej gjuhëve në përdorim parashihet në dokumentet kushtetuese të njësive federative socialiste të Maqedonisë që nga viti 1946 e deri tek amandamentet e fundit të kushtetutës socialiste të vitit 1989. Shpallja e pavarësisë së Maqedonisë në vitin 1991 përveç sfidave në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare do të përballlet me sfidën e brendshme të marrëdhënieve ndëretnike të cilat tani do të duhej të ndërtoheshin në një platformë tjetër dhe pa ideologjinë e dikurshme. Në këtë drejtim aspekti i përdorimit institucional të gjuhës shqipe si njëra nga vlerat identitare të trajtuara dhe në kushtetutat paraprake përbën debatin dhe sfidën në procesin e dhjetëvjeçarit të parë të shtetndërtimit të këtij vendi. Në këtë punim bazë analize është kushtetuta e Maqedonisë së pavarur e vitit 1991 dhe vendi i gjuhës shqipe në kuadër të këtij dokumenti dhe argumenteve dhe

kundërrargumenteve sa i përket përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe. Temë e këtij punimi janë edhe rekomandimet e Komesarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat lidhur me çështjet identitare.

Terma kyçe: marrëdhënie ndëretnike, gjuhë amtare, kushtetutë, identitet, e drejta për gjuhë;

1. SHËNIME HYRËSE

Gjuha, kjo vlerë e jashtëzakonshme dhe e veçantë vetëm për qeniet njerëzore, kjo shprehje e ndjenjave, kjo mundësi komunikimi, kjo gjuhë që ka ashtu si edhe njeriu lindjen dhe vdekjen e vet, jo rastësisht është jo vetëm një nga çuditë inspiruese për të kuptuar njeriun si qenie e veçantë, por njëkohësisht edhe inspirim filosofik që nga antika e deri më sot. Dhe akoma më inspiruese, akoma më provokokative në kuptimësitë e gjera teorike është gjithësesi shumësia e gjuhëve, ai dallim mes tyre i cili po aqë sa është i ndryshëm dhe i pakuptueshëm në shikim të parë, mban brenda vetes në çelës të padukshëm komunikimi dhe mirëkuptimi sado të ndryshme mes tyre qofshin ato gjuhë. Është kjo shumësi e gjuhëve e shprehur si *Kulla e Babelit* nga Derrida, ajo e cila sfidon jo vetëm të kuptuarit dhe të komunikuarit, por njëkohësisht sfidon edhe relacionet të cilat ndërtohen mes popujve dhe këto relacione nuk nënkuptojnë vetëm të komunikuarit mes tyre, por edhe relacionet institucionale dhe politike ndërkomunikuese. Në këto relacione gjuhësore, specifike mbetet e pambaruara e pakompletuara sepse *Kulla e Babelit jo vetëm që përshkruan shumësinë e padiskutueshme të gjuhëve, por njëkohësisht pamundësinë për të përfunduar, kompletuar një konstruktion* (Derrida, 1985:167). Në këto konstelacione mitologjike të problematikës së shumëgjuhësisë dhe konfuzitetit të qëllimshëm për të mos u kuptuar me të ndryshmit nga ne, të kërkuarit e rrugëve të mirëkuptimit dhe komunikimit gjuhësor, mbetet një çështje sfiduese po aqë sa është sfidues dallimi gjuhësor dhe kulturor mes popujve.

Sidoqoftë, duke lëvizur nga mitologjia dhe duke ecur nëpër shekuj edhe një herë vërtetojmë faktin e pamohueshëm të krijimit të identitetit komb-shtet në shekullin e XIX dhe gjuhën si pjesë të pandarë të këtij identiteti. Dhe ashtu siç edhe kemi analizuar kohë më parë (Arifi, 2003:38), identiteti gjuhësor shqiptar shkon përtej kufijve politikë të shtetit të atëhershëm shqiptar, dhe me fragmentimet e mëvonshme të viteve 90, bëhet shprehja kryesore identitare për shqiptarët të cilët jetojnë tanimë jo vetëm jashta territorit të Shqipërisë, por edhe jashtë territorit të Shtetit të Kosovës. Në këto kohëra kur shumësia e identiteteve përcakton *paradigmën e interkulturalizmit* (Zapata-Barrero, 2017:2), qasja mendjehapur ndaj shumëgjuhësisë është ajo e cila na mundëson të kuptuarit e problemit dhe zgjidhjet eventuale të tij.

2. GJUHA SHQIPE NË VORBULLËN E DEKONSTRUKSIONIT DHE KONSTRUKSIONIT

Nëse do vazhdonim me konceptin që dekonstrukcioni që në pikënisje ka qenë dekonstrukcion i totalitares (Derrida, 1999:24), atëherë shpërbërja e Federatës Jugosllave e cila rezultoi me formimin e shteteve të pavarura në kufijtë administrativë të republikave të mëhershme socialiste dhe Maqedonia nuk ishte përjashtim nga ky proces. Por ky proces ishte turbulent nëse kemi parasysh konceptet e ndryshme në të kuptuarit të shtetit i cili ishte në krijim e sipër. Parimi politik maqedonas në shtetformimin konsistonte në konceptin e shekullit XIX, pra një shtet-një komb-një gjuhë, duke konceptuar kështu vetëm një komb, atë maqedonas si bartës të sovranitetit shtetëror, parim i cili u sfidua politikisht nga shqiptarët, me argumentimin e të drejtave që i takonin kësaj popullate sipas dokumentave dhe konventave ndërkombëtare të shekullit XX. Apo siç do të definohet dhe ndryshe, ky konflikt edhe pse në dukje të parë etnik, në thelb përbën një betejë për status zyrtar të këtyre dy komuniteteve (Piacentini, 2019:461). Aspekti tjetër me shumë rëndësi në formimin e këtyre shteteve të pavarura kishte të bënte me faktin që shpërbërjet e federatave ishin rezultat i drejtpërdrejtë i rënies së komunizmit, dhe procesi i shtetformimit do të lidhej me zgjedhjet shumëpartiake që duheshin organizuar në këto vende si dhe referendimet të cilat do të duhej të ishin vendimet popullore për të formuar këto shtete. Duke ndjekur këtë dinamikë, formohen edhe partitë e para politike në Maqedoninë e atëhershme, parti politike të cilat kanë parashtesën politike dhe ideologjike, por që janë të ndara përgjatë vijave etnike. Në blokun etnik maqedonas do të diferencohen dy parti politike: LSDM (Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë) si parti e blokut të majtë dhe VMRO-DPMNE (Organizata e Brendshme Revoluconare Çlirimtare-Partia Demokratike për Bashkim Kombëtar Maqedonas) si parti politike e blokut të djathtë, ndërkohë që në blokun politik shqiptar do të veprojnë PPD (Partia për Prosperitet Demokratik) si parti më e madhe shqiptare e pasuar nga PDP (Partia Demokratike Kombëtare) si parti më e vogël shqiptare e po të njëjtit blok. Debat etno-politik shqiptaro-maqedonas bartet tanimë në parlament dhe ky debat i ashpër dhe intensiv i zhvilluar vetëm në gjuhën maqedonase është dëshmi e një beteje identitare. Dhe njëkohësisht shikuar akoma më gjerë, ky debat konfliktuos kishte natyrën e vet ideologjike dhe politike (Banac, 1992:147). Koncepti politik maqedonas duke imponuar vullnetin etnik në emër të shumicës duke injoruar vullnetin etnik të shqiptarëve dëshiron që nëpërmjet të *nacionalizimit të vonuar të shoqërisë* (Balibar, 2000:88), të vendosë themelet e një shteti që ka vetëm një bashkësi etnike titullare dhe kjo realizohet si me Referendumin për Pavarësinë e Maqedonisë ashtu edhe me votimin e Kushtetutës së Maqedonisë së pavarur. Sipas Preambulës së kësaj Kushtetute është fakt historik që,

Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllehtë, romët dhe nacionalitetet e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, Preambula).

Edhe përkundër diskutimeve të shumta, intensive dhe të argumentuara të depuetëve shqiptarë në përbërjen e parë të parlamentit të Maqedonisë së pavarur, kjo kushtetutë u votua me shumicën e votës maqedonase duke injoruar vullnetin politik të shqiptarëve të Maqedonisë së viteve 90, vullnet ky i shprehur nëpërmjet antarëve shqiptarë të zgjedhur në zgjedhje demokratike në parlamentin e atëhershëm. Apo mosvotimi i kushtetutës ishte shenjë revolte i pasuar edhe nga largimi i përkohshëm nga parlamenti (Kuqi, 2021:57). Në kuptimin teorik, Ashtu siç përshkruan Brubejker procesin e *nacionalizimit* si një proces të shkrirjes së më shumë identiteteve të ndryshme në një identitet të vetëm etnik si bazament i shtetit-komb (Brubaker, 1996:60), e ngjashme është edhe teoria e Balibar, me faktin që ky i fundit konsideron se kur ky proces kalon kufinj të kohorë thellë në shekullin XX, atëherë është një *nacionalizim i vonuar*.

Gjuhët janë flamujt e popujve të shtypur. Ata nëpërmjet gjuhës shprehin idealet e tyre dhe në gjuhën e vet e kanë armë në luftën kundër robërisë, (Hagege, 1992:12)- fjali kjo e cila përshkruan në një formulim të qartë dhe plastik raportin e shqiptarëve të RMV me gjuhën e tyre. Me shpërbërjen e Federatës Jugosllave, kjo pjesë e popullatës shqiptare mbetej pa një qendër institucionale, kulturore, universitare dhe gjuhësore, rol të cilin e kishte kryeqendra e Kosovës së atëhershme si krahinë autonome dhe si qendër arsimore universitare për të gjithë shqiptarët e ish-Jugosllavisë. Pa asnjë institucion të vetin shkencor apo arsimor të nivelit të lartë (përpos një Katedre për gjuhën dhe një shkolle pedagogjike), popullata shqiptare e këtij vendi kishte vetëm një vijë të fuqishme identitare e cila nuk mund ti shqitej dhe ajo ishte gjuha shqipe. Mundësi të ndalohej përdorimi i flamurit, të minimizohej numri i klasëve në gjuhën shqipe në shkollat e mesme, asnjë mbishkrim të mos ishte në gjuhën shqipe, por ama nuk mund ti merrej gjuha nga gjuha, kjo thjesht ishte e pamundur. Prandaj edhe gjuha shqipe përbën boshtin identitar të formimit etnik dhe politik të shqiptarëve në këtë vend, si identitet i cili është i vetëdijshëm për ekzistencën e vet dhe mbi të gjitha si identitet supra-klasor dhe supra-religjioz. Rruga e bërë deri më tani gjatë këtyre tri dekenieve të ndërtimit dhe zhvillimit identitar të shqiptarëve shënon kalimin nga koncepti i kategorisë kulturore të *grupit etnik*, në kategorinë socio-politike të *kombit*, dhe e tëra kjo si një rrugë akoma e pambaruar në shprehjen dhe nivelet e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe. Gjuha amtare ishte ky bosht i rëndësishëm i cili i kishte mbijetuar koncepti ideologjik për të amalgamuar dhe shkrirë identitetet kombëtare një një identitet jugosllav (Banac, 1990:143).

Duke pasur parasysh këto fakte të mësipërme është e qartë të mësohet arsyeja identitare e kësaj beteje për gjuhën shqipe. Duke e definuar shtetin si shtet nacional të kombit maqedonas në preambulën e kushtetutës së vitit 1991, dhe gjithnjë duke pasur parasysh faktin që Preambula është pjesë deklarative e Kushtetutës, por ajo që përfundimisht vulos anashkalimin e gjuhës shqipe është pjesa normative e cila idenë e shtetit nacional të një kombi e jetëson nëpërmjet pjesëve normative të kushtetutës të cilat kanë të bëjnë me gjuhën. (AZGJ, 2021:41). Këto pjesë normative njohin vetëm një gjuhë zyrtare, atë maqedonase si identitet të vetëm etnik maqedonas i cili me anë të këtyre dispozitave kushtetuese është edhe identitet gjuhësor shtetëror. Sipas nenit 7 të kësaj kushtetute:

Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e nacionaliteteve, në përdorim zyrtar, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik janë edhe gjuha dhe alfabeti i nacionaliteteve në mënyrë të përcaktuar me ligj. (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, neni 7)

Ky dokument i cili gjuhës shqipe i jep një karakter lokal, pra përdorim në disa njësi të vetëadministrimit lokal, dhe i cili më tej, sanksionon përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë mësimore vetëm në shkollimin fillor dhe të mesëm, por jo edhe në atë universitar, është dëshmia kryesore e mungesës së vullnetit politik tek bashkësia etnike maqedonase për të vendosur shtetin e ri në themelet e barazisë etnike dhe kulturore si një vlerë themelore e cila do të garantonte jo vetëm përparimin dhe stabilitetin e shtetit të ri, por do të ndërtonte kohezion të brendshëm për një përballje më të suksesshme me sfidat identitare-gjuhësore që ky shtet kishte me fqinjët e vet, Bullgarinë dhe Greqinë. Është ai koncept i mospërfaqësimit të *tjetrit* në kuptimin identitar i cili do të prodhojë krizat ballkanike (Todorova, 1997:4). Në këtë Kushtetutë, përkatësisht nenin 48 parashihet që pjesëtarët e nacionaliteteve të kenë të drejtë lirisht ti shprehin kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale dhe Republika paraqitet si garantues i mbrojtjes së identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar, mirëpo pa qartësuar se cilat janë ato garanca sidomos kur kemi parasysh faktin që ky tekst kushtetues nuk parasheh garanca institucionale për mbrojtje të identiteteve etnike të ndryshme nga identiteti etnik i titullarit kushtetues. Ndërkohë që aspektin e mbrojtjes institucionale kjo kushtetutë e lë në dorën e bashkësive etnike pa përcaktuar bartësin e institucionit që duhet të zhvillojë dhe mbrojë identitetin etnik: *Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre.* (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, 1991, neni 48).

Dhe është pikërisht kjo mungesë e rregullimit të përdorimit të gjuhës shqipe në dokumentin themelor të shtetit të ri që do të krijojë bazën e konceptit për të ridefinuar ndërtimin dhe të kuptuarit e shtetit, ridefinim i cili për bazë të vetën do të kishte barazinë gjuhësore dhe etnike, apo solli kërkesat e mirë-artikuluara për barazi gjuhësore mes shqiptarëve dhe maqedonasve (Andeva, Sela, Matovski, 2022:115).

3. DHJETË VITE REKOMANDIME NDËRKOMBËTARE

Theksuam që argumenti kryesor i përfaqësuesve politikë shqiptarë në debatin për Kushtetutën e Maqedonisë së pavarur (1991), ishin të drejtat e trashëguara kombëtare sa i përket sovranitetit të vendit, gjuhës shqipe dhe përdorimit të simboleve kombëtare. Nga sa pamë më sipër, këto të drejta lidhen me kushtetutën e vitit 1974, nëse kemi parasysh faktin që para kësaj kushtetute nuk kemi standarde juridike që definojnë barazinë dhe pjesëmarrjen e shqiptarëve në sovranitetin e Maqedonisë, kurse në vitin 1989 kemi abrogimin e këtyre zgjidhjeve kushtetuese. Për këtë arsye lëvizjet shqiptare për të bojkotuar referendumin për pavarësinë e Maqedonisë dhe për të organizuar referendum alternativ për autonomi janë trajtuar si lëvizje të provokuara nga ngushtimi edhe i këtyre të drejtave deklarative të kushtetutës së vitit 1974 (Petiffer, 2001:138). Debati parlamentar për këtë kushtetutë vuri në pah logjikën e ndryshme në të kuptuarit e shtetit në formim, edhe atë ishte ky debat mes dy koncepteve: atij maqedonas i cili kishte mendimin për të krijuar shtetin me identitetet monoetnik duke nacionalizuar identitetet tjera në përgjithësi dhe atë shqiptar në veçanti, dhe konceptit politik shqiptar i cili pluralizmin politik dhe demokratizimin e kuptonte si një formë obligative të njohjes së të drejtës për sovranitet, gjuhë dhe simbole kombëtare. Në ato vite kur tanimë kishte filluar lufta qytetare në vendet e ish-Jugosllavisë dhe në kohën kur akoma ishte i fuqishëm ndikimi politik i Beogradit, partitë politike maqedonase dhe përfaqësuesit e tyre në parlament përdorën metodën e mbivotimit për të sjellur kushtetutën e vitit 1991, e cila përveçse nuk kishte sens për kërkesat politike shqiptare, ishte kushtetutë në frymën e amandamenteve kushtetuese të vitit 1989. Kjo frymë e karakterizon tekstin e Preambulës kushtetuese dhe nenet 7 dhe 48 që përcaktojnë çështjet e identitetit etno-kulturor dhe përfaqësimit të këtij identiteti. E tërë kjo eksperiencë dëshmoi se demokracia *majoritare*, sipas të cilës shumica qeveris dhe pakica kritikon është problematike kur është fjala për çështjet etnike, duke qartësuar se gjithësesi që ky koncept do të sfidohej nga koncepti i demokracisë konsensuale (Ljiphard, 2012:32). Koncepti i një demokracie në të cilën do të parashikoheshin mekanizma mbrojtës nga ky lloj majorizimi i cili nuk prodhonte mirëkuptim, por përkundrazi prodhonte konflikt. Kështu që i tërë ky proces prodhonte konflikt i cili sipas logjikës së vet nuk ishte përjashtim nga rrethanat e përgjithëshme të Ballkanit të fundit të shekullit XX në të cilin u gërshetuan urrejtja e motshme etnike, konflikti i armatosur dhe krizat institucionale (Woodward, 1995:52).

Duke pasur parasysh faktin që gjatë kësaj periudhe kohore në territoret e ish-federatës Jugosllave zhvillohej luftë e përgjakshme qytetare dhe duke pasur parasysh faktin që Maqedonia e sapopavarësuar ishte fragjile ndërkombëtarisht dhe akoma më fragjile për shkak të relacioneve të brendshme etnike, Komuniteti Ndërkombëtar krijoi disa modele të intervenimit të cilat ishin në fuqi përgjatë tërë këtij dhjetëvjeçari. Në kuptimin e sigurisë si një shembull parandalimi veçohet misioni i OKB-ve i cili gjatë asaj periudhe turbulente luajti rolin e vet me shume rëndësi (Ackermann, 2003:339). Në kuptimin e marrëdhënieve ndëretnike, pas anëtarësimit të Maqedonisë si anëtare e OSBE-së në vitin 1993, fillon mandati i Komesarit të Lartë për Minoritetet i cili dallohet me një numër të madh rekomandimesh drejtuar autoriteteve shtetërore, rekomandime këto të cilat përfshijnë të gjitha fushat problematike në kuptimin e marrëdhënieve ndëretnike, përkatësisht akomodimit të kërkesave shqiptare.

Që në fillim të Mandatit të tij, Komisioneri i Lartë, Van Der Shtul, do të vendosë theksin mbi çështjen e funksionimit të Komisionit për Marrëdhënie Ndëretnike në kuadër të parlamentit, duke konsideruar se është një institucion i cili mund të kontribuojë në çështjet delikate dhe konfliktuoze (HCNM, OSCE:1993) si dhe duke përsëritur aspektin e përdorimit të gjuhës shqipe si gjuhë shkollimi në nivelet universitare, duke veçuar rëndësinë që ka procesi i shkollimit të lartë në barazinë e shanseve dhe integrimin e bashkësive tjera në shoqëri (HCNM, OSCE:1995). Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve mbesin të porealizuara meqë rekomandimet e Komesarit të Lartë për të ngritur në nivelin e përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe përgjatë periudhës 1991-2001 u trajtuan si të rrezikshme për natyrën unitare të shtetit të Maqedonisë, duke qenë se ky shtet mëtonte të ndërtohej si shtet me një gjuhë zyrtare ekskluzive – atë maqedonase. Megjithatë gjatë kësaj periudhe kemi rekomandime të vazhdueshme për tu angazhuar në një dialog të mirëfilltë lidhur me kërkesat e komunitetit etnik shqiptar. (HCNM, OSCE:1998). Vendimi pas vitit 1992 për të inkuadruar partitë shqiptare si pjesë qeverisëse nuk ishte i parëndësishëm, por, megjithatë ky akomodim qeveritar nuk arriti të krijonte tek shqiptarët ndjenjën kolektive të përkatësisë ndaj institucionit shtet, mes tjerash edhe për shkak të mosnjohjes së përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe si një nga shenjat kyçe të identitetit shqiptar. (Server, 2019:53). Prandaj edhe vazhdojnë Rekomandimet e Komesarit të Lartë, dhe në të njëjtën linjë janë edhe rekomandimet e Asamblesë parlamentare të KE, në të cilat nënvizohet rekomandimi që përdorimi i gjuhës shqipe në institucione të lehtësohet konform Konventës për Gjuhët e Minoriteteve dhe të implementohen rekomandimet e Komesarit të Lartë lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe në

shkollimin universitar. (COE:2001). Po qe se analizohen me kujdes raportet ndërkombëtare për Maqedoninë përgjatë këtij dhjetëvjeçari duket qartë se përdorimi i gjuhës shqipe në Maqedoni shikohet, analizohet dhe raportohet si i pandarë nga procesi arsimor, përkatësisht e drejta për të përdorur gjuhën shqipe si gjuhë shkollimi universitar, duke qenë se me kushtetutën dhe ligjet e para vitit 2001 nuk ishte e lejuar që gjuha shqipe të ishte gjuhë mësimi në një insitucion universitar. Pas shumë protestave dhe kundërprotestave më vitin 1997 ndryshoi ligji për arsimin e lartë që mundësoi funksionimin në gjuhën shqipe të fakultetit pedagogjik në Shkup (Rosulek, 2001:48), ndërkohë që autoritetet e atëhershme nuk njohën legalitetin e Universitetit të Tetovës, i cili filloi me punë më 17 dhjetor të vitit 1994. Ky aspekt krijoi tensione akoma më të mëdha dhe gjithësesi vuri në pyetje praninë e Misionit të KB-ve në vend si një mision i cili ishte shumë i ngadalshëm kur ishte fjala për çështje të brendshme etnike (Ackermann, 2000:162, Petiffer, 2001:141, Veremis, 2014:85). Në këtë drejtim ndërkombëtarisht u vlerësua që institucioni i Komesarit të Lartë për Minoritetet në kuadër të OSBE-së ishte më i pranueshmi për të intervenuar në këtë çështje, dhe në deklaratën e bërë nga ky institucion pas këtyre zhvillimeve në Tetovë, Komesari i Lartë do të pranojë dhe njohë të drejtën për shkollim universitar në gjuhën shqipe, por duke theksuar se e gjitha duhet të jetë në harmoni me ligjet e vendit dhe si përfundon propozon rishikim të Ligjit për arsim universitar si formë për të akomoduar këto kërkesa gjuhësore dhe identitare.(HCNM,OSCE:1995).

4. SHËNIME PËRMBYLLËSE

Nga sa u tha më lart, konstatojmë se gjatë dhjetëvjetëshit të parë pas pavarësisë së vitit 1991, gjuha shqipe në Maqedoninë e Veriut nuk u njoh si gjuhë e karakterit zyrtar, ashtu siç edhe nuk u krijuan mundësitë ligjore dhe kushtetuese për arsimim në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet e shollimit. Pasojat e injorimit të kësaj të drejte thelbore të zhvillimit identitar ishin të thella në kuptimin e rritjes së shkallës së tensioneve dhe konfliktit ndër-etnik. Ndryshimet reale të statusit gjuhësor vijnë si rezultat i Marrëveshjes së Ohrit e cila i adreson poashtu edhe të gjitha Rekomandimet njëdekadëshe të Komesarit të Lartë dhe krijon kornizën për zgjidhje kushtetuese të këtyre problemeve identitare. Në kuadër të këtyre ndryshimeve bën pjesë edhe korniza ligjore me Ligjin për Përdorim të gjuhëve si ligj special, realizimi në praktikë i të cilit përbën një sfidë më vehte. Janë këto leksione që Maqedonia e Veriut i mësoi nga pësimet (Treneska-Deskoska, 2017:66) dhe ashtu si është e një rëndësie të veçantë pjekuria për të mbajtur këto vlera të arritura gjuhësore, po aqë me rëndësi është edhe pjekuria për të mbajtur vlerat demokratike në kohë të rritjes së autoritarizmit në Ballkan si një rrezik i drejtpërdrejtë ndaj proceseve demokratike (Bieber, 2020:31). Shumësia e gjuhëve mbetet një pasuri e madhe e shoqërive shumëgjuhësore, ndërkohë që akomodimi i këtij realiteti gjuhësor në dokumente ligjore dhe institucione dëshmon pjekurinë e përgjithëshme të një shoqërie dhe një shteti.

LITERATURA

- Ackermann, A.(2000), *Making Pace Prevail, Preventing Violent Conflict in Macedonia*, Syracuse University Press;
- Ackermann, A. (2003), The Idea and Practice of Conflict Prevention, *Journal of Peace Research*, Vol40. No.3, Sage Publications Ltd;
- Andeva, M.,&Sela, Y.,& Matovski,L., (2022), Languages and Identities in North Macedonia: Legal and Political Challenges to State Formation, *MPRA Paper* No.116695, <https://mpa.ub.uni-muenchen.de.>;
- Arifi, T (2003), Identiteti etno-politik i shqiptarëve të Maqedonisë; *Universitas*, nr.3, Vienë;
- Balibar, E.&Wallerstein,I. (1991) *Race, Nation,Class, Ambiguous Identities*, London-New York , Verso;
- Banac, I. (1990), Political Change and National Diversity, *Daedalus Vol. 119/1*, MIT Press on Behalf of American Academy of Arts&Sciences, <https://jstore.org>;
- Banac, I. (1992), The Fearful Asymmetry of War: The Causes and Consequences of Yugoslavia's Demise, *Daedalus*, Vol. 121/2, MIT Press on Behalf of American Academy of Arts&Sciences, <https://jstore.org>;
- Bieber, F. (2020), *The Rise of Authoritarianism in the Western Balkans*, Palgrave Macmillan;
- Bloodwoth, A. (2020), Educational (de)segregation in North Macedonia: The intersection of policies, schools and individuals, *Educational Research Journal*, Vol.19. Issue 4, Sage Journals;
- Brubaker, R. (1996), *Nationalism refrained, Nationhood and the National Question in the New Europe*, Cambridge University Press;
- Derrida, J. (1985), *Des Tours de Babel, Difference in Translation*, Edited by Joseph. F.Graham, Ithaka&London, Cornell University Press;
- Derrida, J. (1999), *Çaste Filozofike*, Tiranë, Tirana L Times;
- Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019, (2021), *Konferenca shkencore ndërkombëtare për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare*, Punimet e konferencës, Shkup, Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së;
- Hagege, C. (1992), *Le souffle de la langue*, Paris, Editions Odile Jackob;

- Correspondence between HCNM and the former Yugoslav Republic of Macedonia regarding inter-ethnic relations and education rights, (1993, 1995, 1998), *OSCE Official*, <https://www.osce.org>;
- Koneska, C.&Huskic,A.&Krasniqi, G. (2023), Macedonia, Bosnia and Kosova: contested statehood and the EU, *Journal of Intervention and Statebuilding*, Vol.17, Issue 2, Routledge;
- Kuqi.D. (2021), The Post-Communist Evolution and Constitutional-Legal Engineering of the Model of Democracy in North Macedonia (1990-2001); *European Journal of Multidiciplinary Studies*, Vol 6, Issue 2;
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (1991), *Gazeta Zyrtare e RM*, nr 52/91, <https://www.slvesnik.com.mk>;
- Ljiphart, A. (2012), *Patterns of Democracy*, Yale University Press;
- Pettifer, J. (1999), *The new Macedonian Question*, London, Palgrave Macmillan;
- Piacentini, A.M. (2019), State Ownership and “State sharing”: The Role of Collective Identities and the Sociopolitical Cleavage between Ethnic Macedonians and Ethnic Albanians in the Republic of North Macedonia, *Nationalities Papers*, Volume 47, Issue 3, Cambridge University Press;
- Report of European Comission against Racism and Intolerance on “The Former Yougoslav Republic of Macedonia” (2001), Strasbourg, Council of Europe, <https://www.coe.int>;
- Rosulek, P. (2002), Albanians in the Republic of Macedonia (1991-2001), Could the attempt to create a Multiethnic Society Succeed, *Perspectives*, N.17, pp.43-58, www.jstor.org;
- Todorova. M. (1997), *Imagining the Balkans*, New York, Oxford University Press;
- Treneska-Deskoska R. (2017), Accomodating Multilingualism in Macedonia, *Social Inclusion*, Vol.5, Issue 4;
- Serwer D. (2019), *From War to Peace in the Balkans, Middle East and Ukraine*, Palgrave Macmillan;
- Veremis, Th. (2014), *The Modern Balkans: A concise giude to Nationalism and Politics, The rise and Decline of Nation State*, London, LSEE;
- Woodward, S.L. (1995), *Balkan Tragedy: Chaos and Dissolution after the Cold War*, Washington D.C. Brookings Institution Press;
- Zaçellari, M.& Shala, F. (2022), Minority languages in Europe: Problems of Albanian as the Second Official Language in North Macedonia, *International Journal of Evaluation and Research in Education*, Vol.12. No.4;
- Zapata-Barrero, R. (2017), Interculturalism in the post-multicultural debate: a defence, *Comparative Migration Studies*, No.5;